



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,  
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT

AGJENCIA E MENAXHIMIT  
TË BURIMEVE UJORE  
Nr. 1891 Prot.  
Datë, më 11.9.2023

Nr. 4416/3 Prot.

Tiranë, më 8/9 / 2023

Lënda: Mbi dërgimin e Raportit të vlerësimit e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore

**AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**  
Adresa: Blv "Zhan D'Ark", Prona.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Në zbatim të nenit 25 dhe 26, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, dhe Metodologjisë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitet e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.311, datë 23.12.2020, në vijim të dërgimit të projekt raportit me shkresën nr. 4416/1 datë 29.06.2023 dhe komenteve të dërguara nga ana e institucionit nëpërmjet shkresës nr.1029/1 datë 07.07.2023, bashkëlidhur Ju dërgojmë "Raportin e vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm", për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Të gjitha rekomandimet e përmendura në këtë raport, duhet të përfshihen në planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, pasi ky plan do të përbëjë bazën e punës për ndjekjen e procedurave në të ardhmen, i cili dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së bashku me raportimin vjetor të institucionit për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

MINISTËR  
DELINA IBRAHIMAJ



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,  
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT

**RAPORT**

**VLERËSIMI I CILËSISË SË SISTEMIT TË  
KONTROLLIT TË BRENDSHËM**

**DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,  
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT**

**NË**

**AGJENCINË E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**

---

Tiranë 2023

# PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
II. HYRJA.....	4
III. METODA E VLERËSIMIT.....	6
IV.GJETJET.....	7
4.1 MJEDISI I KONTROLLIT.....	7
4.2 MENAXHIMI I RISKUT.....	8
4.3 AKTIVITETET E KONTROLLIT.....	9
4.4 INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI.....	9
4.5 MONITORIMI.....	10
V. REKOMANDIMET.....	10

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bazuar në nenin 25 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK) është përgjegjëse për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Me qëllim përmirësimit të standardeve të punës si dhe analizimin dhe vlerësimin me detaje të gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënien e rekomandimeve për adresimin e mangësive të identifikuara, në zbatim të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, është hartuar Metodologjia për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 311, datë 23.12.2020. Në këtë kuadër, DH/MFKK ka planifikuar realizimin e procesit të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në disa njësi të qeverisjes së përgjithshme të përcaktuara në planin e miratuar të drejtorisë nr. 3554, datë 20.02.2023.

Procesi i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm do të shërbejë për identifikimin e mangësive kryesore të sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe planifikimin e rekomandimeve të nevojshme për adresimin e tyre. Në përfundim të procesit të vlerësimit, hartohet një projekt-raport dhe raport i detajuar me gjetje dhe rekomandime të cilat duhet të ndiqen në vazhdimësi mbi ecurinë e veprimtarisë së tyre nëpërmjet planit të veprimit të MFKK.

Përgjatë datave 29 Maj – 02 Qershor 2023, subjekti i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm ishte veprimtaria e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, njoftuar nëpërmjet shkresës nr. 4416, datë 06.03.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Objektivat e vendosura lidhur me këtë vlerësim ishin:

- Verifikimi nga ana e DH/MFKK të gjendjes së zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (KB), duke ekzaminuar bazën dokumentare sipas secilës rubrikë të listës së kontrolleve;
- Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektin e vlerësuar.

---

### Gjetjet dhe konkluzionet kryesore

Nga vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm rezultoi se:

1. Veprimtaria e institucionit mbështetet në disa rregullore si: Rregullore për sjelljen e nëpunësve të AMBU” miratuar me urdhër nr. 179 prot, datë 21.11.2019 dhe “Rregullore për parandalimin e konfliktit të Interesave” miratuar me urdhër nr. 181 prot, datë 02.12.2019, gjithashtu draft rregullore “Për metodat e brendshme të punës për sjelljen e personelit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrate të Administrimit të Baseneve Ujore”;
2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore vepron në mbështetje të objektivave të përcaktuara në PBA 2023-2025;
3. Vepohet në mbështetje të planeve të punës që monitorohen çdo muaj, si dhe raportimet për realizimin e tyre nga zyrat e varësisë, por jo një plan i konsoliduar për të gjitha objektivat e institucionit sipas bazës rregullative të fushës së menaxhimit financiar dhe kontrollit;
4. Janë marrë masat për zbatimin e procesit të menaxhimit të riskut në institucion, por duhet të zhvillohen më tej instrumentat kryesorë të këtij procesi;

5. Evidentohet përdorimi i delegimi si instrument i menaxhimit sipas ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
6. Janë hartuar gjurmë të auditimit për procese kryesore, por jo të miratuara nga drejtuesi institucionit;
7. Evidentohet të jenë hartuar harta të proceseve të punës, por jo të miratuara nga drejtuesi institucionit;
8. Në institucion nuk ka njësi të auditimit të brendshëm.

## Rekomandimet kryesore

Mbështetur në gjetjet e konstatuara, për përmirësimin e situatës në zbatimin e sistemit të KB, rekomandojmë si më poshtë:

1. Ndërtimi i instrumentit të MFK, manuali i proceseve të punës, në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualit të MFK, për të gjithë institucionin;
2. Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të riskut në përputhje me ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe udhëzimi nr.16 datë 20.07.2016 “Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e riskut në njësitë publike”;
3. Përfshirjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik në realizimin e funksioneve ligjore për sa i përket fushës së MFK-së;
4. Përdorimin më të shpeshtë të instrumentit të delegimit në përputhje me bazat ligjore në fuqi të MFK (ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe udhëzimi nr.4 datë 29.01.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”);
5. Nëpunësi Autorizues mund të monitorojë sistemin e KB nëpërmjet përdorimit të metodologjisë së monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike.

## II. HYRJA

Vlerësimi i cilësisë në Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore bazohet në nenin 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe në Metodologjinë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 311, datë 23.12.2020.

Në përfundim të vlerësimit të mbështetur në listën e kontrollove të miratuar me urdhërin e sipërpërmendur hartohet ky projekt raport i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, dhe brenda **7 ditëve punë nga dërgimi i këtij projekt raporti**, niveli i lartë drejtues i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore mund të reagojë në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura.

Nëse nuk do të ketë asnjë reagim nga institucioni i vlerësuar atëherë do të konsiderohet i ezauruar ky hap dhe do të vijohet me dërgimin e raportit përfundimtar.

Nëse Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, pas marrjes së komenteve me shkrim nga drejtuesi i institucionit, do të vijohet me organizimin e një takimi përmbyllës.

Pas realizimit të takimit përmbyllës me punonjësit e DH/MFKK, këta të fundit e konsiderojnë të përmbushur misionin e tyre dhe dërgojnë raportin përfundimtar brenda **10 ditëve punë nga realizimi i këtij takimi**, duke njoftuar drejtuesin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore mbi plotësimin e planit të veprimit dhe dërgimin e tij pranë DH/MFKK.

Informacioni mbështetës për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore bazohet në listën e kontrolleve të plotësuar dhe dokumentacionet e paraqitura për secilën pikë, pyetësorin e vetëvlerësimit, planin e veprimit të MFK, raportin vjetor për vlerësimin e sistemit të KB nga ana e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Vlerësimi nga grupi vlerësues u mbështet në dokumentacionet e sipërcituara.

## **2.1 KOMENTET E SUBJEKTIT DHE QËNDRIMI I GRUPIT TË VLERËSIMIT**

Bazuar në vlerësimin e kryer, gjetjet dhe rekomandimet e të cilit janë paraqitur në projekt-raport me shkresën nr. 4416/1, datë 29.06.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, subjekti i vlerësuar ka paraqitur sqarimet/komentet përkatëse si dhe ka vendosur në dispozicion dokumentat plotësues me shkresën nr.1029/1, datë 07.07.2023.

**Grupi i vlerësimit ka shqyrtuar dhe analizuar komentet e subjektit dhe dokumentacionin plotësues duke dhënë sqarimet përkatëse si më poshtë:**

- Përsa i përket Gjetjes në pikën nr.5, Rubrika 4.1 është vlerësuar dhe marrë në konsideratë dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e institucionit;
- Mbi Gjetjen në pikën nr.12, Rubrika 4.1, merret në konsideratë dokumentacioni i përcjellë nëpërmjet observacionit, konkretisht shkresa nr. 2029, datë 12.12.2022 “Kërkesë për shpallje pozicioni” dërguar nga AMBU në DAP (në lidhje me procedurat e rekrutimit);
- Mbi Gjetjen në pikën nr.13 në Rubrika 4.1, është vlerësuar dhe marrë në konsideratë dokumentacioni i vënë në dispozicion, që në fazën e projekt – raportit;
- Mbi Gjetjen në pikën nr.4, Rubrika 4.2 vlerësohet paraqitja e Urdhërit nr.31 datë 17.03.2023 “Për ngritjen e GMR” dërguar nëpërmjet observacionit;
- Mbi Gjetjen në pikën nr.3, Rubrika 4.3, është vlerësuar dhe marrë në konsideratë dokumentacioni i vënë në dispozicion që në fazën e projek – raportit, por është rekomanduar përdorimi më i shpeshtë i këtij instrumenti;
- Mbi Gjetjen në pikën nr.5, Rubrika 4.3, duhet të merren masa për hartimin e regjistrit të aktiveve, pasi nëpërmjet observacionit nuk është dërguar ndonjë dokument justifikues;
- Mbi Gjetjen në pikën nr.6, Rubrika 4.3, duhet të ndërveprohet me AKSHI-n, në mënyrë që të menaxhohet pjesa e IT, pasi në përgjigjet në listën e kontrolleve nuk është dhënë informacion dhe gjithashtu nuk ka një specialist IT që mund të menaxhohet nga AKSHI;

- Përsa i përket Gjetjes në pikën nr.2, Rubrika 4.5 është vlerësuar dhe marrë në konsideratë dokumentacioni i vënë në dispozicion që në fazën e projekt – raportit. Dokumentacioni i dërguar me observacionin lidhet me raportimin për njësitë e varësisë, ndërkohë duhet të mbahet në konsideratë rekomandimi përkatës në hartimin dhe konsolidimin e planit vjetor dhe të raportimeve peridoke të standartizuara mbi objektivat e instiucionit në kuadër të përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Sa më sipër, nga rivlerësimi i kryer bazuar në dokumentacionin justifikues plotësues, sistemi i kontrollit të brendshëm në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore vlerësohet **pjesërisht efektiv, me 28 pika** të plotësuara nga lista e kontrolleve të shoqëruar me dokumentacion justifikues. Gjithashtu janë bërë edhe rregullimet përkatëse në tekstin e raportit në lidhje me dokumentacionin e marrë në konsideratë.

### III. METODA E VLERËSIMIT

Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm është i mbështetur në Metodologjinë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe realizohet përmes vlerësimit të efektivitetit të këtyre sistemeve përkatësisht në: efektiv, pjesërisht efektiv ose joefektiv:

- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **efektiv**, nëse nuk janë zbuluar asnjë ose janë zbuluar shumë pak dobësi dhe mangësi të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **pjesërisht efektiv**, nëse dobësitë dhe mangësitë e zbuluara vlerësohen si të mesme dhe / ose të ulta dhe nuk janë zbuluar dobësi të rëndësishme dhe ngjarje të dëmshme për njësinë në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **jo efektiv** kur ekziston një mangësi e madhe në lidhje me funksionimin e një komponenti ose parimi përkatës, ose në lidhje me komponentët që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar për të gjithë njësinë dhe kjo mangësi ndikon direkt në moszbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në vlerësimin e njërive të qeverisjes së përgjithshme merren në konsideratë:

- Lista e kontrolleve;
- Evidencat mbështetëse;
- Pyetëtori i vetë-vlerësimit;
- Raporti vjetor i kontrollit të brendshëm;
- Vlerësimi i performancës sipas indikatorëve;
- Plani i veprimtimit të MFK;
- Gjetjet e AB dhe KLSH për fushën;
- Vlerësimin e mëparshëm (nëse ka) sipas kësaj metodologjie për njësitë e qeverisjes së përgjithshme të vlerësuara;

Vlerësimi i përgjithshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm llogaritet si më poshtë, në mbështetje të 17 parimeve për 5 komponentët COSO të MFK-së:

1. 71%-100% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plota- efektiv;

2. 41%-70% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plotë- pjesërisht efektiv;
3. 0-40% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plotë - jo efektiv.

Për sa më sipër, nëse njësia që do të vlerësohet rezulton me 48-68 pyetje të plotësuara në bazë dokumentare sipas listës së kontrolleve, do të cilësohet me një sistem të KB efektiv. Nëse rezulton me 28-47 pyetje të plotësuara në bazë dokumentare sipas listës së kontrolleve, do të cilësohet me një sistem të KB pjesërisht efektiv dhe 0-27, sistem të KB jo efektiv.

Informacionet përkatëse të vlerësimit përfshihen në Raportin Vjetor mbi Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

#### **IV.GJETJET**

Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore u mbështet në listën e kontrolleve dhe dokumentacionet që e shoqërojnë atë, sipas parimeve përkatëse për secilin komponent të Modelit COSO.

##### **4.1 MJEDISI I KONTROLLIT**

Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm, pasi ai ngrë strukturën dhe vendos disiplinën. Faktorët e mjedisit të kontrollit të brendshëm përfshijnë integritetin, vlerat e etikës dhe profesionalizmin e punonjësve të njësisë; filozofinë dhe stilin e punës së titullarit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë apo si organizon dhe zhvillon punonjësit në njësi, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

##### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Parimi 2 - Titullari / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstronë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Parimi 3 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.

Parimi 5 - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Rezultoi se:

1. Struktura organizative e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore është miratuar me Urdhër nr.152, datë 01.10.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, e ndryshuar me Urdhër nr.17, datë 30.01.2020 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr.152, datë 01.10.2018 të Kryeministritë “Për miratimin e strukturës dhe organikës të AMBU”;
2. Institucioni i AMBU ka “Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018 -2027”, miratuar me VKM nr.73, datë 07.02.2018;
3. Evidentohen draft rregullore “Për metodat e brendshme të punës për sjelljen e personelit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore” (dërguar në Kryeministri me shkresën nr. 1897, datë 17.11.2022 për miratim), e cila duhet të finalizohet me miratim sa më shpejt;

4. Gjithashtu janë të miratuara nga drejtuesi i institucionit “Rregullore për sjelljen e nëpunësve të AMBU” me urdhër nr. 179 prot, datë 21.11.2019 dhe “Rregullore për parandalimin e konfliktit të Interesave” me urdhër nr. 181 prot, datë 02.12.2019;
5. Në institucion nuk ka procedura specifike sinjalizimi apo njësi të ngritur për sinjalizimin;
6. Gjithashtu evidentohet të jetë pjesë e dokumentacionit të vendosur në dispozicion “Programi i transparencës për AMBU” dhe “Menaxhimi i Integruar i Burimeve / Aktiviteti i AMBU për vitin 2022” ( të pa miratuara);
7. Përsa i përket funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), si një nga organet vendimarrëse lidhur me çështjet kryesore të institucionit, rezulton se ky grup është ngritur me urdhër nr.16, datë 12.01.2022 “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik për vitin 2022” dhe gjithashtu urdhëri nr. 01, datë 05.01.2022 “Për krijimin e Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor”, por nuk evidentohet i dokumentuar trajtimi i çështjeve që lidhen me MFK në mbledhjet e këtij grupi;
8. Objektivat e institucionit janë të përcaktuara në PBA 2023 -2025, shkresa nr. 1470 prot, datë 30.08.2022;
9. Evidentohet “Plani veprimit 2019 - 2022” si dhe “Plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin 2022”, si raportime dhe jo formate të miratuara nga drejtuesi;
10. Evidentohet përdorimi i delegimit sipas kërkesave ligjore të fushës së menaxhimit financiar dhe kontrollit “Autorizim për delegimin e kopetencave të nëpunësit zbatues” me urdhërin nr. 1956 prot, datë 24.11.2022”, (*por vetëm për këtë rast*) si dhe raportimi mbi ekzekutimin e detyrimeve sipas autorizimit për delegimin e kopetencave të NZ;
11. Procedura e rekrutimit realizohet në mbështetje të kuadrit ligjor nëpërmjet DAP, evidentohet shkresa drejtuar DAP me nr.2029, datë 12.12.2022 “Kërkesë për shpallje pozicioni”;
12. Trajnimet për institucionin realizohen kryesisht në mbështetje të programit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (dorëzuar lista e trajnimeve për AMBU për periudhën 2018-2022) dhe nga projekte apo donatorë të tjerë ku AMBU është përfituese;
13. Vlerësimet e punës kryhen periodikisht çdo 6 muaj në zbatim të VKM nr.1037, datë 16.12.2015 “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”. Gjithashtu evidentohen dhe formularët e përshkrimeve të punës së punonjësve.

## 4.2 MENAXHIMI I RISKUT

Menaxhimi i Riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të atyre ngjarjeve ose situatave potencialisht të dëmshme për arritjen e objektivave të të gjithë njësisë publike dhe konceptohet për të dhënë garanci të arsyeshme se këto objektiva do të arrihen.

### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 6 - Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.

Parimi 7 – Identifikimi dhe analiza e risqeve.

Parimi 8 – Mundësia e riskut të mashtrimeve.

Parimi 9 – Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.

Rezultoi se:

1. Evidentohet të jetë dorëzuar regjistri i riskut (jo i miratuar);

2. Nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut (plani i masave të menaxhimit të riskut) në funksion të plotësimit të ciklit të menaxhimit të riskut;
3. Funksionet e Koordinatorit të Riskut nuk janë deleguar;
4. Është ngritur Grupi i Menaxhimit të Riskut me Urdhërin nr.31 datë 17.03.2023 “Për ngritjen e GMR”;
5. Nuk është hartuar plan për minimizimin e risqeve, në funksion të monitorimit.

#### **4.3 AKTIVITETET E KONTROLLIT**

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e njësisë duhet të marrin parasysh përfitimin që priten prej tyre, si dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

##### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 10 –Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.

Parimi 11 – Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrolli mbi teknologjinë.

Parimi 12 –Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Rezultoi se:

1. Janë ndërtuar gjurmë standarte të auditimi, (gjurma e auditit për procedurën e zbatimit të planit të veprimit në mbështetje të strategjis së AMBU dhe vlerësimi i performancës të menaxhimit të burimeve ujore) evidentuar kjo me dokumentacion, por jo të miratuara. Gjithashtu janë hartuar harta të proceseve të punës, por jo të miratuara;
2. Është ndërtuar një manual procesi pune, i pa miratuar;
3. Evidentohen raste delegimi të funksioneve sipas ligjit të MFK për disa raste (NA, NZ), por ky instrument duhet të përdoret më shpesh në institucion;
4. Procedura për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit evidentohet me dokumentin “Administrimi i dokumentacionit zyrtar të AMBU”, firmosur nga drejtuesi dhe administruar si proces nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
5. Nuk është evidentuar një bazë dokumentare për të vërtetuar mbajtjen e një regjistri për aktivitet;
6. AMBU nuk ka një rregullore të brendshme për TI dhe specialist përkatës.

#### **4.4 INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI**

Komponenti i katërt i kontrollit të brendshëm ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësisë publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

#### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 13 -Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.

Parimi 14 -Komunikimi i brendshëm.

Parimi 15 -Komunikimi i jashtëm.

Rezultoi se :

1. Procesi i komunikimit në institucion funksionon duke u realizuar nëpërmjet shkresave dhe email-eve zyrtare (evidencë; memo “Informacion mbi të ardhurat e arkëtuara për dhjetor 2022” përgatitur nga Drejtoria e Financës për drejtuesin e institucionit);
2. Konstatohen të dërguara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: shkresa nr. prot. 1470, datë 30.08.2022 “Dërgimi i PBA 2023 – 2025 Faza II” dhe shkresa nr. 2061 prot, datë 16.12.2022 “Dërgimi i PBA 2023 – 2025 Faza III”;
3. Rezulton si raportim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, shkresa me nr.136/1, datë 20.01.2023 “Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për katër mujorin e III të vitit 2022”;
4. Gjithashtu evidentohet shkresa me nr.81 prot, datë 16.01.2023 “Raport mbi veprimtarinë e Autoritetit Përgjegjës në AMBU për vitin 2022” dërguar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.

#### **4.5 MONITORIMI**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efëçente me kalimin e kohës. Në kryerjen e monitorimit, titullari i njësisë, nëpunësi autorizues dhe menaxherët e tjerë, duhet t’i kushtojnë vëmendje gjendjes së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe objektivave të arritura.

#### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 16 - Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe / ose të veçanta.

Parimi 17 - Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Rezultoi se:

1. Institucioni i AMBU ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shkresën me nr.149 prot, datë 28.02.2023, ku janë bashkëlidhur pyetësori i vetëvlerësimit për vitin 2022, deklarata, raporti për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin për vitin 2022 (plani i veprimit rezulton jo efektiv, pasi është dërguar formati i vjetër dhe jo për veprimtarinë e vitit 2023);
2. **Nuk evidentohet një raportim periodik i konsoliduar për objektivat (jo me karakter financiar) e institucionit tek drejtuesi i njësisë dhe ndjekjen e tyre;**
3. Në institucion nuk ka njësi të auditimit të brendshëm, por kontrollohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, evidentuar kjo me shkresën nr.107/14 prot, datë 22.09.2022 dërguar nga KLSH

“Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e performancës me temë ‘Menaxhimi i burimeve ujore’, ushtruar në AMBU”.

## V. REKOMANDIMET

Në mbështetje të gjetjeve të sipërcituara, rekomandojmë sa më poshtë vijon:

1. Të realizohen instrumentat kryesorë për menaxhimin e riskut në mbështetje të regjistrit të riskut të institucionit (i cili duhet të miratohet nga drejtuesi i institucionit), sipas përcaktimeve rregullative të fushës, strategjia e menaxhimit të riskut (plani i masave për menaxhimin e riskut) dhe plani i veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre;
2. Në kuadër të përmirësimit të proceseve dhe procedurave ekzistuese të punës, rekomandojmë që në bazë të informacionit të përmbledhur hartat e proceseve të punës të finalizohen me miratim;
3. Të ndërtohen manualët e proceseve të punës;
4. Të miratohen gjurmë auditimi;
5. Gjatë takimeve të GMS të trajtohen problematikat që lidhen me MFK-në duke e shtrirë fokusin në vlerësimin e gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e këtij sistemi;
6. Të hartohet dhe miratohet plani vjetor i konsoliduar dhe të mbahet parasysh fakti i raportimit në mënyrë periodike të planit të veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së te Nëpunësi Autorizues;
7. Të përdoren në më shumë raste procedurat e delegimit sipas ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke mbajtur në konsideratë përmbajtjen e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 29.01.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
8. Të gjitha rekomandimet e sipërpërmendura duhet të përfshihen në planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (sipas formatit të ri), pasi ky plan do të përbëjë bazën e punës për ndjekjen e procedurave në të ardhmen dhe duhet të dërgohet me shkresë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**MINISTËR**

**DELINA IBRAHIMAJ**

